



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, me 12 dhjetor 2011  
Nr. ref.: RK173/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI 42/11**

Parashtruesi

**Dedë Bala**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Komonale të Prishtinës P. nr. 2630/2006, Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Ap. nr. 242/2007 dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl. nr. 101/2010**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi është Dedë Bala, nga Komuna e Gjakovës.

## **Objekti i çështjes**

2. Parashtruesi pohon shkeljen e nenit 7.1.[Vlerat], nenit 31 [e Drejta në Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] paragrafi në lidhje me nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa), nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenit 102 paragrafi 2 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi, gjithashtu pretendon shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

## **Baza juridike**

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit nr. 03/L -121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Vendimet e kontestuara**

4. Në kërkesën e tij parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës P. nr. 2630/2006, të datës 26 mars 2007. Ai gjithashtu, konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Ap. nr. 242/2007, të datës 27 maj 2010, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl. nr. 101/2010, të datës 30 dhjetor 2010.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 28 shkurt 2011, parashtruesi dorëzoi një letër me argumente për ankesë në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 mars 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Në kërkesën e tij, parashtruesi gjithashtu kërkon masë të përkohshme për të suspenduar dënimin e tij me burgim, deri në kohën kur Gjykata Kushtetuese të vendosë dhe vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të kontestuara.
8. Më 18 prill, Kryetari emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Kadri Kryeziu.
9. Më 29 nëntor 2011, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 26 mars 2007, Gjykata Komunale e Prishtinës në Vendimin e vet P. nr. 2630/2006, gjeti parashtruesin fajtor për shmangie nga tatimi sipas nenit 249 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/25, në tekstin e mëtejme: KPPK).
11. Gjykata Komunale e dënoi parashtruesin me një vit vuajtje burgimi, pas aktgjykimit të formës së prerë e detyruës dhe gjobiti atë me 12,000 €, të cilën shumë duhej ta paguajë brenda një viti në 12 këste të barabarta, nga data e aktgjykimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm. Dënimi, gjithashtu mbulon kohën që parashtruesi e kishte kaluar në paraburgim prej 11 dhjetorit 2006 deri më 26 mars 2007.

12. Parashtruesi, gjithashtu ishte i detyruar t'ia kompensojë palës së dëmtuar dëmin material me pagesën e shumës prej 31,914.17 € brenda 15 ditëve prej kur aktgjykimi merr formën e prerë.
13. Gjykata Komunale vërejtë se e mira materiale e fituar me kryerjen e veprës penale nga ana e të akuzuarit arrin shumën prej së paku 212,761.15 €. Në këtë rast konfiskimi i fitimit nuk ishte i mundshëm kështu që dallimi mes fitimit neto dhe dëmeve (180,846.98 €) duhej paguar Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.
14. Parashtruesi u ankua ndaj aktgjykimit në Gjykatën e Qarkut. Ai pretendon se kishte shkelje procedurale në kundërshtim me dispozitat e nenit 403, paragrafi 1, pika 9 dhe 12, paragrafi 2 pika 1 dhe 2, të Procedurës së Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26, në tekstin e mëtejshëm: PKPPK). Ai arriti në këtë përfundim sepse ai ishte marrë në pyetje nga një zyrtar i Drejtorisë së Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë, para paraqitjes së provave, dhe ai pohon se deklarata e tij ishte e cunguar dhe ai ishte përjashtuar nga përdorimi dhe paraqitja e provave materiale gjatë marrjes në pyetje që nga dita e arrestimit e tutje. Ai pohon se aktgjykimi ishte kontradiktor dhe nuk përmban arsye për fakte vendimtare, ngritjes së aktakuzës nuk i kanë paraprirë veprimet hetuese, të cilat ai besonte se do të vërtetonin në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, dhe e drejtat e tij për mbrojtje ishte shkelur pasi që ai nuk ishte lejuar të përdorë dokumente që ka pasur në dispozicion, në dobi të mbrojtjes së tij, që nga momenti i arrestimit të tij.
15. Parashtruesi, gjithashtu pohon se ka pasur shkelje të nenit 404 paragrafi 1, pikat 1,2,4 dhe 5 të PKPPK, sepse vepra për të cilën ai ishte ndjekur penalisht nuk ishte e parashikuar si vepër penale sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/20 për Administratën Tatimore, që ka qenë në fuqi me 30 prill 2005. Vepra penale sipas nenit 15 paragrafi 1 i KPPK nënkupton qëllimin për t'iu shmangur tatimeve gjë që parashtruesi nuk e kishte për qëllim. Aktgjykimi mes tjerash ishte i bazuar në dispozitat e nenit 71 të PKPPK i cili parasheh mundësinë e shqiptimit të dënimeve për bashkimin e veprave penale, përderisa dihet se parashtruesi ishte i akuzuar vetëm për një vepër penale, kryerja e të cilave nuk ishte dëshmuar nga Gjykata Komunale dhe përfundimisht Gjykata Komunale ka vendosur gjendjen faktike gabimisht.
16. Më 27 maj 2010, Gjykata e Qarkut të Prishtinës në vendimin e vet Ap. nr. 242/2007, miratoi pjesërisht ankesën dhe ndryshoi dënimin në lidhje me aktgjykimin mbi dënimin, rrjedhimisht, Gjykata Supreme zvogëloi dënimin e parashtruesit në nëntë muaj. Duke arsyetuar këtë vendim Gjykata e Supreme pohon se aktgjykimi origjinal i Gjykatës Komunale nuk ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese në nivelin e kërkuar, veçanërisht pasi që parashtruesi kishte një familje dhe kundër tij nuk është zhvilluar procedurë penale më herët.
17. Gjykata e Qarkut shprehet se aktgjykimi i kontestuar ishte konkret dhe i qartë, nuk kishte kontradikta përbrenda vetes dhe në arsyet e paraqitura në aktgjykimin e kontestuar. Gjykata e Qarkut nuk ka vërejtur se në aktgjykimin e kundërshtuar kishte shkelje themelore të PKPPK, gjendja faktike ishte e argumentuar në mënyrë të drejtë e të plotë. Sipas përfundimeve dhe opinionit të Gjykatës, eksperti financiar dhe Gjykata Komunale në mënyrë të drejtë kanë zbatuar ligjin penal kur kanë vlerësuar që veprimet e parashtruesit përmbajnë elemente të veprës penale të shmangies së tatimit, sipas nenit 249 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPPK. Sipas kësaj, pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pandryshuar.
18. Më 12 gusht 2010, parashtruesi dorëzoi një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë duke u bazuar në shkeljen e nenit 403 paragrafi 1 dhe 12, po ashtu edhe paragrafi 2 pika 1 e PKPPK dhe nenit 404 paragrafi 1 pikat 1,2,4 dhe 5 të PKPPK.

19. Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e vet Pkl. nr. 101.2010, të datës 30 dhjetor 2010, refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë. Gjykata Supreme shprehet se ankesa e parashtruesit që ai ishte marrë në pyetje nga zyrtarët e Drejtorisë për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit para se të jepej ndonjë provë, nuk ishte shkelje e nenit 403 paragrafi 1, nën paragrafi 9, dhe asnjë provë nuk ishte klasifikuar si e papranueshme dhe pohimet se e drejta e parashtruesit ishte shkelur doli të ishte e pabazë sepse procesverbali i shqyrtimit gjyqësor tregoi se ai ka gëzuar të gjitha të drejtat e parashikuara me ligj dhe atij i është dhënë mundësia për të mbrojtur veten gjatë të gjitha fazave të procedurës penale.
20. Gjykata Supreme shprehet se derisa vepra penale për shmangie të tatimit nuk parashihet me Rregulloren 2000/20 për Administratën tatimore, parashihet me nenin 249 paragrafi 2 i KPPK. Gjithashtu mbulohet edhe nga Ligji Penal i Kosovës (në tekstin e mëtejme: LPK) i cili zbatohet deri në vitin 2004, kur u aprovua KPPK. Sidoqoftë, pasi që KPPK parashih një dënim më të lehtë për veprën penale të evazionit fiskal sesa LPK, kjo ishte zbatuar në përputhje me ligjet e zbatueshme si ligji më i favorshëm për të akuzuarin.
21. Pretendimi i parashtruesit se ai nuk e ka ditur që veprimet e tilla janë të ndaluara sepse ai ka mbaruar vetëm shkollën fillore dhe ishte ligjërish dhe faktikisht i mashtruar, sipas Gjykatës Supreme, është absurd për faktin se i pandehuri së pari pohoi se një ligj i pazbatueshëm është zbatuar dhe se rezoluta ishte bazuar në dëshmi të papranueshme. Pastaj, pohoi se nuk konfirmohej se i akuzuari kishte kryer veprën penale, për të përfunduar në fund se i akuzuari në fakt ka fshehur-shmangien e taksave, por ishte mashtruar, gjë që është plotësisht kontradiktore.

### **Pretendimet e parashtruesit**

22. Parashtruesi pretendon se kishte shkelje të nenit 7 paragrafi 1 i Kushtetutës, sepse gjykatat kanë dështuar të respektojnë parimet e pajtueshmërisë me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe me sundimin e ligjit, në të cilën është bazuar rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.
23. Parashtruesi pohon se gjykatat kanë dështuar t'i ofrojnë atij mbështetje të plotë dhe të duhur në mbrojtjen e të drejtave të tij, siç garantohet me Kushtetutë, pra ata nuk arritën të gjykojnë si duhet mosmarrëveshjen penale-juridike. Sipas tij, gjykatat për këtë arsye kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
24. Parashtruesi pretendon se gjykatat kanë dështuar t'i ofrojnë atij mbrojtjen e duhur ligjore, sikurse garantohet me nenin 54 të Kushtetutës.
25. Parashtruesi pohon se gjykatat kanë shkelur nenin 102 paragrafi 2 të Kushtetutës që parashih: "Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik, e i paanshëm...", sepse gjykatat kanë marrë vendime në kundërshtim me ligjin dhe në dëm të parashtruesit.

### **Vlerësimi paraprak për masa të përkohshme**

26. Sa i përket kërkesës së parashtruesit që Gjykata Kushtetuese të lëshojë një masë të përkohshme për të suspenduar dënimin e tij me burgim, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk përmbajnë prova dhe arsyetime të mjaftueshme që mund të justifikojnë lejimin e masës së përkohshme.

27. Në veçanti, parashtruesi nuk ka treguar, ashtu si kërkohet me nenin 27 të Ligjit, se ai do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk i lejohet masa e përkohshme. Për më tepër, nuk është treguar që vënia e masave të përkohshme do të ishte në interes të publikut.
28. Prandaj, nuk janë përmbushur kushtet për vënien e masës së përkohshme dhe kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet.

### **Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë**

29. Në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese.
30. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se sipas rregullit 36(1) (c) “Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa është qartas e bazuar.”
31. Rregulli 36 (2) i Rregullores së punës më tej parasheh:  
*“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartas të pabazuar nëse bindet se:*
  - a) *Kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
  - b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
  - c) *Gjykata vëren se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkelje të drejtave kushtetuese të garantuara me Kushtetutë, ose*
  - d) *kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
32. Parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, KEDNJ Vendimi për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
33. Gjykata konstaton se pohimet e parashtruesit për *inter alia*, shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 dhe 13 të Konventës, po ashtu edhe nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës, janë tërësisht të paargumentuara.
34. Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka drejtuar pretendimet e parashtruesit në aktgjykimin e vet Pkl. nr. 101.2010, të 30 dhjetorit 2010. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata Kushtetuese nuk vëren se procedurat relevante kanë qenë të padrejta në ndonjë mënyrë, ose të njollosura me arbitraritet (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, KEDNJ vendimi për papranueshmërinë e kërkesës nr. 17964/06, të 30 qershorit 2009).
35. Gjykata përfundon se kërkesa është qartazi e pabazuar, në kuptim të nenit 36 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Snezhana Botusharova

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani

